

## THIRRJE PËR SHPREHJE TË INTERESIT

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
PROJEKTI PËR EFIKASITET ENERGJETIK NË SEKTORIN PUBLIK  
(IBRD 9038 MK)  
NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË PROJEKTIT : P149990  
**MK-MOF-007-2023-CS-CQS**

### **NDIHMË TEKNIKE: MBIKËQYRJA E PUNËVE TË NDËRTIMIT PËR ZËVENDËSIMIN E SISTEMIT TË NDRIÇIMIT PUBLIK RRUGOR NË KOMUNËN E LLOZOVËS, RANKOVCIT DHE DEBËRCËS**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka marrë hua nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore për implementimin e Projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik. Qëllimet për zhvillimin e projektit janë: (i) reduktimi i konsumit të energjisë në sektorin komunal; dhe (ii) përkrahja e zhvillimit dhe zbatimit të mekanizmit të qëndrueshëm për financimin e efikasitetit energjetik në sektorin publik. Projekti ka si pikësynim t'i arrijë këto qëllime përmes mundësisë së investimeve në ndërtesat komunale dhe ndërtesat e Qeverisë (qendrore) dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Në përputhje me kushtet e marrëveshjes, synohet që një pjesë e mjeteve të destinohen për të ofruar ndihmë teknike për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit për zëvendësimin e sistemit të ndriçimit publik në Komunën e Llozovës, Rankovcit dhe Debërcës.

Shërbimet e konsulencës përfshijnë kryerjen e mbikëqyrjes së punëve të ndërtimit për zëvendësimin e sistemit të ndriçimit publik në Komunën e Llozovës, Rankovcit dhe Debërcës, si dhe mbikëqyrjes së menaxhimit gjatë periudhës së garancisë. Informacione më të detajuara në lidhje me kualifikimet e nevojshme mund të gjeni në linkun e mëposhtëm: [https://finance.gov.mk/proekt\\_z\\_energetska\\_efikasnost/](https://finance.gov.mk/proekt_z_energetska_efikasnost/).

Ministria e Financave u bën thirrje kompanive të kualifikuara konsulente (“konsulentëve”) të shprehin interesin për sigurimin e shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të dorëzojnë informacione me të cilat do të konfirmohet se ata posedojnë kualifikimet e nevojshme dhe përvojën përkatëse për t'i realizuar shërbimet. Kompania duhet t'i posedojë dhe plotësojë kualifikimet e mëposhtme:

#### **Përvoja dhe kualifikimet e konsulentit:**

##### ***1) Aftësia profesionale e konsulentit***

- Personi juridik duhet të posedojë licencë të vlefshme B për mbikëqyrje, e lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut / në rastin e investimit të përbashkët, të paktën njëri nga anëtarët në investimin e përbashkët duhet të posedojë licencë të vlefshme B për mbikëqyrje, e lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Së paku 20 të punësuar të përhershëm që punojnë për konsulentin, të konfirmuar nga institucioni zyrtar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Punën duhet ta kryejë ekipi i konsulentëve, që përbëhet nga ekspertë me aftësitë dhe kualifikimet e nevojshme të përcaktuara në ToR-in. Ekipi do të përbëhet minimum nga 5 ekspertë kryesorë, të punësuar nga konsulenti.

## 2) Përvoja e përgjithshme dhe specifike e konsulentit

### 2.1 Përvoja e përgjithshme e konsulentit:

Konsulenti duhet të dëshmojë aftësinë dhe përshtatshmërinë, respektivisht ta dëshmojë përvojën e tij të përgjithshme siç është Mbikëqyrja e çështjeve të ndërtimit, në 7 vitet e fundit në afatin përfundimtar të parashtrimit, duke dorëzuar listën e referimit.

### 2.2 Përvoja specifike e konsulentit

Konsulenti duhet të bashkëngjisë listë të referimit për së paku 3 marrëveshje të përfunduara me sukses për shërbime mbi mbikëqyrjen e rikonstruksionit/ndërtimit/zëvendësimit të ndriçimit publik në 5 vitet e fundit.

## 3. Certifikatat e nevojshme për përmbushjen e standardeve të mëposhtme:

ISO 9001: 2018

ISO 14001: 2015

ISO 45001:2015

Konsulentët mund të bashkëpunojnë me kompani të tjera si investim i përbashkët ose si nënkonsulentë me qëllim që t'i përmirësojnë kualifikimet e tyre.

“Shoqata” mund të jetë në formë të investimit të përbashkët ose të zyrës nënkonsulente. Në rast të investimit të përbashkët (IP), të gjithë anëtarët e IP-së së bashku do të vlerësohen për qëllimet e listës së shkurtër dhe do të jenë përgjegjës në mënyrë të përbashkët dhe individuale për detyrat dhe do të nënshkruajnë marrëveshje në rast të ofrimit të investimit të tyre të përbashkët (IP). Konsulentët e interesuar duhet qartazi ta cekin strukturën e “shoqatës” së tyre dhe detyrat e partnerëve dhe nënkonsulentëve gjatë aplikimit të tyre. Mënyra e paqartë e shprehjes së interesit në aspekt të formave “në bashkëpunim me” dhe/ose “në lidhje me” dhe ngjashëm nuk mund dhe nuk do të merret parasysh për listën e shkurtër. Si parim, duke pranuar një shprehje interesi për kompani, kompania konsulente duhet të vendosë nëse dëshiron të marrë pjesë si nënkonsulent ose si konsulent individual, apo si partner i investimit të përbashkët (IP). Ju lutemi të merret parasysh fakti se kompania duhet të parashtrorë vetëm një shprehje interesi në procesin e njëjtë të përzgjedhjes ose veçmas si konsulent ose si partner i investimit të përbashkët. Asnjë kompani nuk mund të jetë nënkonsulent përderisa parashtron shprehje interesi veçmas ose si partner i investimit të përbashkët (IP) në procesin e njëjtë të përzgjedhjes. Kompania, nëse vepron në cilësinë e nënkonsulentit me çfarëdo konsulenti apo investimi të përbashkët (IP), atëherë mund të marrë pjesë me më shumë se një konsulent, por vetëm në cilësinë e nënkonsulentit.

Informacione shtesë mund të merren në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës nga ora 8:30 - 16:30, nga e hëna deri të premten.

Shprehja e interesit duhet të parashtrorë në formë të shkruar në adresën e mëposhtme (personalisht, përmes postës ose email-it) më së voni deri më 3 Nëntor të vitit 2023 në orën 16:30.

Ministria e Financave  
Projekti për efikasitet energjetik në sektorin publik  
rr. Dame Gruev, nr. 12, 1000 Shkup  
Republika e Maqedonisë së Veriut  
Drejtuar znj.Tatjana Velichkoviq, PSEEP-EIP  
Tel/faks: ++ 389 2 3120352  
tatjana.velichkovik@finance.gov.mk